

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti për krime të rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Have Haliti, kryetare, Driton Muharremi e Abdullah Ahmeti, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Syzana Goxhuli, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit A.G. nga ..., për shkak të veprave penale Blerja, posedimi, shpërnadarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, supstancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 të KPRK e lidhur me nenin 281 çar.1 pika 1.9 të KPRK-së dhe veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par.1 e KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë dhe ankesës së mbrojtësit të akuzuarit A.G., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Mitrovicë P.nr. 134/2017 datë 06.12.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me 06.02.2018 mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. Aprovohet ankesa e mbrojtësit të akuzuarit A.G., ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore - Departamenti për Krime të Rënda në Mitrovicë P.nr. 134/2017 datë 06.12.2017 vetëm përkitazi me vendimin për dënim, ashtu që Gjykata e Apelit e Kosovës, të akuzuarin A.G. për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor e gjykon me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 5 viteve, në të cilin dënim i llogaritet edhe koha e kaluar në masën e paraburgimit prej datës 06.06.2017 e tutje, ndërsa ia merr si të vërtetuar dënimin unik me gjobë në shumë prej 3500 (tremijë e pesqindë) euro.
- II. Refuzohet si e pa bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Mitrovicë-departamenti për krime të rënda, me aktgjykimin P.nr. 134/2017 datë 06.12.2017, të akuzuarin A.G. e ka shpallur fajtor për shkak të veprave penale Blerja, posedimi, shpërnadarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, supstancave psikotrope dhe analoge nga neni 273 par.1 të KPRK e lidhur me nenin 281 çar.1 pika 1.9 të KPRK-së dhe veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par.1 e KPRK-së, duke i shqiptuar dënim si për veprën penale në pikën 1 të dispozitivit me dënim me gjobë në lartësi prej 3.000 euro, dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 vite, për veprën penale në pikën 2 të dispozitivit me dënim me gjobë në lartësi prej 500 euro. Në mbështetje të nenit 80 të KPRK-së të akuzuarit i shqipton dënimin unik, në dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 vite dhe dënim me gjobë në lartësi prej 3.500 euro. Në këtë dënim i llogaritet edhe koha e kaluar nën masën e paraburgimit nga data 06.06.2017 e gjer në plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. I akuzuari në rast se nuk e paguan dënimin me gjobë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi dënimin me gjobë do ti zëvendësohet me dënim me burgim në mbështetje

të nenit 46 par.3 ku 20 euro të gjobës do ti llogariten me 1 (një) dite burgim. Në mbështetje të nenit 282 e lidhur me nenin 62 të akuzuarit i shqiptohet Marrja e Sendit – Konfiskohen : dy vetura të markës “Shkoda Octavia” me targa MTF-209 me numër shasie TMBDX41U088835244 dhe vetura e markës “Ford Fokus” me targa NUV-705 me numër shasie UF0OMXGCDM7C3599, që të dy këto automjete së bashku me dokumentacionin përcjellës dhe çelësat e tyre dhe dy peshore digjitale Hyndai dhe First, si dhe makina elektrike për paketimin e substancës narkotike përmes vakumit. Të gjitha këto sende Agjencioni për administrimin e pasurisë se sekuestruar apo konfiskuar pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi urdhërohet që këto sende ti shes, në përputhje me dispozitat ligjore. Konfiskohen substancat narkotike të llojit marihuanë me peshë të përgjithshme me peshe të përgjithshme 136 kg e 555 gr., si dhe një revole M-57 kalibri 7.62mm, me numër serik 33667. Të gjitha këto sende policia është e obliguar që pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi ti shkatërroj në përputhje me dispozitat ligjore. Obligohet i pandehuri që të paguaj shpenzimet procedurale- paushallin gjyqësore në lartësi prej 150 euro pas plotfuqishmërinë së këtij aktgjykimi, për shpenzimet tjera gjykata do të vendos pas sigurimit të listës definitive të shpenzimeve për çka do të vendoset ma aktvendim të veçantë. Kërkesë pasurore- juridike nuk kishte.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjorë ankesë ka paraqitur:

-Prokuroria Themelore në Mitrovicë, për shkak të Vendimit mbi dënim, me propozim që Gjykata e Apelit ta ndryshoj aktgjykimin e shkallës së parë dhe ndaj të akuzuarit A.G. të shqiptohet një dënim më i ashpër.

-Mbrojtësi i të akuzuarit A.G., av. A.L., për shkak të Shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljeve të ligjit penal dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën, aktgjykimi atakuar të anulohet dhe lënda të kthehet në rigjykim, urdhërohet Gjykata Themelore në Mitrovicë që të caktoj një tjetër gjyqtarë për rigjykimin e kësaj çështje penale.

Gjykata e Apelit e Kosovës e caktoj dhe e mbajti seancën kolegjit konform dispozitës së nenit 390 par.1 të KPP, për të cilën i njoftoj palët. Në seancë nuk prezantoi Prokurori i Apelit, kurse prezent ishte i akuzuari A.G. dhe mbrojtësi i tij av. A.L.. Mbrojtësi mbeti pranë pretendimeve ankimore ndërsa i akuzuari përkrahi mbrojtësin e tije.

- Prokurori i Apelit me parashtrësën me shkrim PPA/I.nr.35/2018 të dt. 19.01.2018 ka propozuar që ankesa e mbrojtësit të akuzuarit të refuzohet si e pa bazuar ndërsa të aprovohet ajo e prokurorisë.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje juridiko-penale studio aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

-ankesa e Prokurorisë Themelore është e pa bazuar, ndërsa ajo e mbrojtësit është e bazuar përkitazi me vendimin mbi dënim .

Mbrojtësi i të akuzuarit av. A.L. me ankesë pretendon se aktgjykimi është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale pasi që sipas tij gjykata ka shkelur parimin e paanshmërisë së gjykatës dhe të barazisë së palëve kur para marrjes

së vendimit ka thirrur prokurorin në zyrën e tij se këtë e vërteton me faktin se personi i autorizuar nga gjyqtari në prezencën e vëllait të akuzuarit që është gardian në Burgun e Pejës dhe në prezencën e avokatit por edhe në prezencën e disa pjesëmarrësve tjerë ka kërkuar prokurorin që të shkoj në zyrën e gjyqtarit dhe pas këtij takimi ka shpallur vendimin. Më tej thekson se aktgjykimi i kundërshtuar që iu është dorëzuar palëve nuk përputhet me atë të shpallur në gjykatë pasi që në faqen 5 në paragrafin 4 thuhet se si rrethanë lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale dhe rrethanat e tij pas kryerjes së veprës penale,..... si dhe rrethanë lehtësuese ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri, ndërsa në shqyrtim kryesor gjatë shpalljes së aktgjykimit në prezencë të gjithëve i është drejtuar të akuzuarit “... se nuk ka gjetur asnjë rrethanë lehtësuese por vetëm rënduese për të cilat do ti arsyetoj në aktgjykim me shkrim”. Pastaj në shqyrtim kryesor i ka shqiptuar dënimin unik me gjobë 3000 euro ndërsa është pranuar aktgjykimi me dënim unik 3500 euro. Po ashtu konsideron se është konfuze arsyetimi i gjyqtarit lidhur me zbutjen e dënimit nga neni 75 par.1 nën. par 1.2 ndërsa mbrojtësi ka kërkuar që të aplikohet dispozita e nenit 75 par.1 pika 1.3 e që ka të bëjë me rrethanën posaçërisht lehtësuese e që është pranimi i fajësisë. Këto shkelje kanë ndikuar që të shkelet edhe Kodi Penal e që ka të bëjë me vendimin mbi dënim duke aplikuar gabimisht dispozitat e nenit 74 dhe 75 të KPK.

Gjykata e Apelit me vëmendje ka shqyrtuar aktgjykimin e shkallës së parë, ankesën e mbrojtësit si dhe shkesat e lëndës dhe vlerëson se aktgjykimi i atakuar me ankesë nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale. Sa i përket pretendimit se gjyqtari para shpalljes së aktgjykimit ka pasur një bisedë ex parte, këtë veprim nëse pretendohet se ka ndodhur mbrojtësi i të akuzuarit është dashur që ta adresoj menjëherë tek personat përgjegjës që kanë të bëjnë me shkelje të supozuar të Kodit të Etikës e që pastaj nga kompetentët të vërtetohet një pretendim i tillë. Në rastin konkret kjo gjykatë konsideron se nuk paraqet shkelje esenciale nga neni 384 par.2 pika 2.2 pasi që në këto rrethana nuk mund të vërtetohet një pretendim i tillë e po ashtu edhe rrethana se a është shkelur e drejta e mbrojtjes që ka ndikuar ose që ka mundur të ndikoj në marrjen e aktgjykimit të ligjshëm dhe të drejtë. Sa i përket pretendimit se gjykata gjatë shpalljes së aktgjykimit i ka caktuar dënimin unik me gjobë të akuzuarit në shumë prej 3000 eurove ndërsa në aktgjykim qëndron shuma prej 3500 eurove, kjo gjykatë bëri shiqimin në procesverbalin mbi shpalljen publike të aktgjykimit e ku qëndron dënimi unik me gjobë prej 3500 euro që është identik me aktgjykimin e dorëzuar palëve. Ndërsa sa i përket pretendimit të mbrojtjes lidhur me zbutjen e dënimit ku mbrojtja pretendon se kemi të bëjmë me një arsyetim konfuz me rastin e aplikimit të kësaj dispozite, ky pretendim është i pa bazuar për faktin se me rastin e pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe pas marrjes së mendimit nga ana e prokurorit, mbrojtësit dhe palës së dëmtuar gjykata vendos sa i përket zbutjes së dënimit por nuk detyrohet nga kufizimet e parapara në nenin 76 të KPRK, edhe pse zbutja e dënimit në rastin konkret është e obliguar e që nëse marrim parasysh dispozitën e cila e rregullon veprën penale për të cilën i akuzuari shpallët fajtor atëherë shihet se gjykata ka marr parasysh rrethanat lehtësuese e ndër to edhe pranimin e fajësisë porse ka vlerësuar se nuk janë të natyrës posaçërisht lehtësuese bazuar në rrethanat rënduese që kanë ekzistuar e që të akuzuarit të i shqiptohet dënim nën minimumin e paraparë ligjor.

Duke vlerësuar çështjen përkitazi me pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit lidhur me vendimin për dënim kjo gjykatë konsideron se ankesa e mbrojtësit të akuzuarit e që ka të bëjë me lartësinë e dënimit është e bazuar. Mbrojtësi në ankesën e tij thekson se duke pas parasysh pranimin e fajësisë si dhe rrethanat tjera lehtësuese, ndërsa në anën tjetër rrethanat rënduese nga ana e gjykatës nuk paraqesin rrethana rënduese pasi

që nuk janë të parapara me dispozitën e nenit 74 par.2 të KPK duke konsiderua se dënimi duhet të ketë për qëllim qëllimin e dënimit që të mundësohet risocializimi nepërmjet edukimit. Kjo gjykatë vlerëson se duke pasur parasysh rrethanat lehtësuese të cekura nga gjykata e shkallës së parë, sidomos pranimi i fajësisë si dhe duke mos pranuar kjo gjykatë rrethana rënduese të theksuara nga gjykata e shkallës së parë se i akuzuari edhe më parë ka qenë i gjykuar (pavarësisht pranimit nga ana e tij) për faktin se nuk kemi prova se për çfar veprë penale është gjykuar dhe ky aktgjykim a është i formës së prerë, ia ndryshoi të akuzuarit dënimin e shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke vlerësuar se dënimi i shqiptuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë është i ashpër dhe se dënimi i shqiptuar nga kjo gjykatë është në harmoni të plotë me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale të kryer dhe përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit në kuptim të nenit 41 të KPRK-së.

Ankesa e Prokurorisë lidhur me vendimin mbi dënim është e pa bazuar për faktin se arsyet të cilat kjo gjykatë ia ka zbutur dënimin të akuzuarit e kanë bërë ankesën të pa bazuar e po ashtu edhe mos aprovimi i rrethanave rënduese të theksuara nga ana e prokurorisë në ankesë siç është fakti se i njëjti është recidivist për çka edhe u arsyetua më lartë, si dhe dashja e cila është element konstituiv i veprës penale.

Meqë aktgjykimin nuk është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, gjendja faktike nuk është atakuar me ankesë, nuk kemi as shkelje të Ligjit Penal e që do të kushtëzonte anulimin e këtij aktgjykimi.

Nga sa u tha më lartë, e në pajtim me dispozitën e nenit 401 dhe 403 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.28/18, më 06.02.2018

Procesmbajtëse,
Syzana Goxhuli

Kryetare e kolegjit- gjyqtarja
1. Have Haliti_____

Anëtarët e kolegjit:

2. Driton Muharremi_____

3. Abdullah Ahmeti _____